



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 17

Prishtinë, më 23.6.2015, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Emilija Redzeqi, Adem Salihaj, Lahi Brahimaj, Murat Hoxha, Srdjan Popovic, Haxhi Shala.

Mungoi : Shaip Muja, Salih Salihu.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë : sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi, Dalina Kërqeli.

Mbledhjen e kryesoi **Fikrim Damka**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 16.6.2015,
3. Shqyrtimi i realizimit të planit të punës,
4. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.6.2015

Kryetari i Komisionit konstatoi miratimin e komisionit për procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

3. Shqyrtimi i realizimit të planit të punës së komisionit për sesionin pranveror

Fikrim Damka-kryetar, hapi diskutimin rreth planit të komisionit për këtë vit i cili plan përkundër përpjekjeve të komisionit, nuk po realizohet ashtu si është paraparë, sidomos për arsyet që Qeveria nuk i përmbahet planit të saj legjislativ. I sugjeroi komisionit që në punën vijuese të fokusohet në dy ligje të cilat duhet të monitorohen, Ligjit për inspektionin bujqësor dhe atë për ujëra, ndërkaq për 6 mujorin e dytë të vitit të shikohet cilat ligje të monitorohen.

Murat Hoxha u pajtua me kryetarin, ngase kjo diskrepancë e planit të komisionit dhe qeverisë nuk ishte dashur të ndodhë, nëse plani legjislativ u realizua në marrëveshje me qeverinë, pse ndodhë kjo. Propozoi ti dërgohet një shkresë dhe të kërkohet sqarim nga Qeveria. Ai përsëriti kërkesën për monitorimin e Ligjit për kadastrë i cili ligj përfshin edhe dy ligje tjera (hipotekat dhe regjistrimin e pronave) të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillim ekonomik të vendit, ngase çështja e pronësisë luan rol të madh në një shtet, nëse janë të sqaruara. Apeloj për kthimin e të dhënave kadastrale nga Serbia, përndryshe mbledhja e fakteve kadastrale në një shtet merr kohë deri 100 vite. Nëse nuk realizohet marrëveshja me Serbinë lidhur me këtë çështje, problemet janë evidentuese.

Adem Salihaj u pajtua për dërgimin e një shkrese Qeverisë dhe shtoi se komisioni deri tani ka arsyetuar veten bukur mirë me punën 6 mujore, sidomos në grupin punues rreth grurit të importuar dhe rekomandimeve. Ai ishte i mendimit që Ligjin për Inspeksionin bujqësorë komisioni mund të monitoroi gjatë muajit korrik, nëse ka nevojë me dy grupe punuese.

Kryetari falënderoi dhe sugjeroi veprimet si në vijim :

- Në mbledhjen e radhës të hënën më 29 qershor të formohen dy grupe punuese (**për Projektligjin për rregullimin e shërbimeve të ujit dhe për mbikëqyrjen e Ligjit për inspeksionin bujqësorë**),
- Ti dërgohet Qeverisë shkresa nga komisioni për sqarimin e vonesës së dërgimit të projektligjeve dhe dokumenteve tjera strategjike të parapara me programin e punës së Kuvendit,
- Grupi punues për hartimin e Ligjit për kompleksin memorial Adem Jashari, më 24 qershor viziton këtë kompleks dhe do të definoi punën e mëtejme në këtë grup punues rreth hartimit të ligjit.

Mbledhja përfundoi në orën 14,00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Fikrim Damka